




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Adresa:Rr .Isa Boletini pn. tel.; +381 (0)280 23 603 ,e-mail :
dshcs@gjilani-komuna.org



Nr: _____

Datë: _____ 2015

G j i l a n

Në bazë të nenit: **7, 8, 10 paragrafi 1, nënparagrafi 2.1, nenit: 15**, të Ligjit të Punës **nr: 03/L-212, nenit 5** të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, dhe **U.A. nr: 14/2011** për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale publikon:

K O N K U R S

Titulli: /6/ gjashtë doktor të mjekësisë

- /1/ një për punënë QMF “Pogragjë”
- /1/ një për punë në QMF “Malishevë”
- /1/ një për punë në QMF”Dobërçan”
- /1/ një për punë në QMF “Cërnice”
- /2/ dy për punë në “Shërbimin e ndihmës së shpejt”

Mbikqyrës: Drejtori i QKMF-së

Kushtet:

- Përgatitja superiore/ Fakulteti i Mjekësisë- drejtimi i përgjithshëm/
- Të jetë i licencuar
- Të ketë shkathtësi profesionale për punë të pavarur në profesion
- Të njohë punën me kompjuter

Kontrata e punës: Sipas Ligjit të punës

Koeficienti: 7.20

Orari i plotë i punës: 40 orë në javë

Përshkrimi i shkurtër i punëve: Ofron shërbime shëndetësore nga kujdesi primar shëndetësor , kontrollon pacientët, cakton diagnozat, ndërmerr veprimet e mjekimit të pacientëve, propozon hulumtime dhe masa për trajtimin e sëmundjes, konsultohet me kolegët, punon në QMF në shërbimet përkatëse të mjekësisë familjare, bën implementimin e programit të Mjekësisë Familjare, jep këshilla dhe udhëzime pacientëve sugjeron propozon dhe përshkruan terapinë e nevojshme, për punën e vet i jep llogari shefit të shërbimit dhe Drejtorit të QKMF-së.

Titulli: /1/ një doktor të stomatologjisë

Mbikqyrës: Drejtori i QKMF-së

Kushtet:

- **Pregatitja superiore/ Fakulteti i Mjekësisë- drejtimi i stomatologjisë/**
- **Të jetë i licencuar**
- **Të ketë shkathtësi profesionale për punë të pa varur në profesion**
- **Të njohë punën me kompjuter**

Kontrata e punës : sipas Ligjit të Punës

Koeficienti: 7.20

Orari i plotë i punës: 40 Orë në javë

Përshkrimi i shkurtër i punëve: Kryen kontrollin e parë dhe të përsëritur të sëmurëve nga lëmia e shëndetit oral, bënë edukimin shëndetësor oral, jep udhëzime të nevojshme pacientve, bënë kontrollime sistematike të grupmoshave të ndryshme, bënë mjekimin e dhëmbëve të qumështit dhe përherëshëm, bënë nxjerrjen e tyre dhe shërimin, ordinon terapinë për shërimin e infeksioneve të regjionit oral, bënë heqjen e depozitimeve të forta dhe të buta të dhëmbit, bashkëpunon ngusht me kolegët, kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të shefit dhe drejtorit.

Çdo aplikues për pozitat e lartcekura duhet të plotësoi dhe dorëzoj dokumentacionin me sa vijon:

- **Fletë aplikacionin e plotësuar**
- **Dokumentacionin mbi përgatitjen dhe kualifikimin profesional/ fotokopje/**

Kandidatët të cilët aplikojnë për dy apo më shumë pozita të shpallura janë të obliguar që për çdo pozitë të plotësojnë nga një aplikacion dhe të cekin se për cilën pozitë aplikojnë

Të gjithë kandidatët të cilët hyjnë në listën e ngushtë , do të ftohen në intervistë dhe për datën e mbajtjes së intervistës do të njoftohen me kohë dhe do të intervistohen nga komisioni intervistues.

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Arkivin qendror të Komunës së Gjilanit, gjegjësisht në zyrën për marrdhënie me publikun-shërbimi me qytetarë.

Afati për aplikim **është /15/ pesëmbëdhjetë ditë**, nga dita e shpalljes publike në gazetë ditore, dhe mjete tjera të informimit,

Dokumentet e pa kompletuara dhe ato të cilat arrijnë pas afatit nuk do të shqyrtohen.